



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 30

Tiranë – E premte, 26 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 10/2016, datë 25.2.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes..... 2441
Vendim i Kuvendit nr. 11/2016, datë 25.2.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Financave..... 2441
Vendim i Kuvendit nr. 12/2016, datë 25.2.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Financave..... 2441
Vendim i Kuvendit nr. 13/2016, datë 25.2.2016	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes..... 2441
Dekret i Presidentit nr. 9424, datë 17.2.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2442
Dekret i Presidentit nr. 9425, datë 17.2.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2442
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 1587/1, datë 25.2.2016	Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre për çdo rreth gjyqësor, si dhe mbulimin përkatës për çdo bashki, së bashku me njësitë administrative pranë saj..... 2443
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Rahmi Çomo..... 2447

**VENDIM
Nr. 10/2016****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIMIN E MINISTRIIT TË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, mbështetur në dekretin nr. 9426, datë 17.2.2016, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9426, datë 17.2.2016, për shkarkimin e zotit Arben Ahmetaj nga detyra e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj**

Miraturar në datën 25.2.2016

**VENDIM
Nr. 11/2016****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
SHKARKIMIN E MINISTRIIT TË
FINANCEVE**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, mbështetur në dekretin nr. 9427, datë 17.2.2016, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9427, datë 17.2.2016, për shkarkimin e zotit Shkëlqim Cani nga detyra e Ministrit të Financave.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj**

Miraturar në datën 25.2.2016

**VENDIM
Nr. 12/2016****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIIT TË
FINANCEVE**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, mbështetur në dekretin nr. 9450, datë 22.2.2016, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9450, datë 22.2.2016, për emërimin e zotit Arben Ahmetaj në detyrën e Ministrit të Financave.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj**

Miraturar në datën 25.2.2016

**VENDIM
Nr. 13/2016****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIIT TË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, mbështetur në dekretin nr. 9451, datë 22.2.2016, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9451, datë 22.2.2016, për emërimin e zonjës Milva Ekonomi në detyrën e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARE
Valentina Leskaj**

Miraturar në datën 25.2.2016

**DEKRET****Nr. 9424, datë 17.2.2016****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Majlinda Avni Dedaj (Sulejmani)
2. Neri Mustafa Keçi
3. Teuta Jashik Maçi
4. Fatjon Agim Koçi
5. Aida Myftar Falli
6. Jonida Qazim Kreci
7. Amarilda Gazmend Saraçi
8. Mirjan Imer Mavriqi
9. Eglantina Feti Mavriqi (Mërnica)
10. Damian Mirjan Mavriqi
11. Florjana Marash Marku (Paplekaj)
12. Gentjan Fiat Terolli
13. Arsen Burhan Luku
14. Sidrit Agron Hafizi
15. Dino Petrit Frank (Hasani)
16. Florian Enver Schneider (Bici)
17. Eltion Lekë Shpani
18. Vjollca Kadri Sadrija (Sano)
19. Anila Ibrahim Kumina
20. Florijan Driton Kumina
21. Gerti Festim Fazlli
22. Zorica (Milica) Vasil Gjinoviq (Nikollaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 9425, datë 17.2.2016****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anisa Fatmir Hana
2. Laureta Yzedin Sulanaku
3. Goran (Ilir) Ivan Gjinoviq (Ograja)
4. Alma Vasil Boçi
5. Albana Fatmir Merkaj (Peldszus)
6. Zoran (Armir) Stefo Šunjević (Pranvera)
7. Ergi Edmond Alihoxha
8. Emirjola Agim Kashi
9. Fatmir Nike Qokaj
10. Dragana (Anila) Danil Živanović (Nikollaj)
11. Suela Xhemal Streicher (Gega)
12. Habijana Jemin Dogjoni
13. Hektor Ernesto Kraja
14. Edmira Sherif Volpe (Spahija)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

**URDHËR****Nr. 1587/1, datë 25.2.2016****PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË
PËRGJITHSHËM TË NOTERËVE DHE
NUMRIT TË TYRE PËR ÇDO RRETH
GJYQËSOR, SI DHE MBULIMIN
PËRKATËS PËR ÇDO BASHKI, SË
BASHKU ME NJËSITË
ADMINISTRATIVE PRANË SAJ**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 dhe 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

Konstatohet se:

Noteria, si profesion i lirë në Republikën e Shqipërisë, zë një vend të veçantë për shkak të rëndësisë së rolit të saj në stabilitetin e veprimeve juridike dhe vërtetimit të akteve. Për shkak të kësaj rëndësie, ligji nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, ka parashikuar një numër të kufizuar noterësh, në mënyrë që të ruhet ekuilibri, nga njëra anë, midis aktivitetit të tyre ekonomik dhe rolit të tyre si funksionar publik, dhe nga ana tjetër, cilësisë dhe shpejtësisë në ofrimin e shërbimeve noteriale kundrejt qytetarëve në njësitë e qeverisjes vendore.

Me urdhër të ministrit të Drejtësisë nr. 158, datë 9.4.2013 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre sipas njësive të qeverisjes vendore”, numri i përgjithshëm i noterëve është 443. Sipas nenit 16 të ligjit nr. 7829/1994, ministri i Drejtësisë, në bazë të numrit të popullsisë dhe të vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë, cakton çdo dy vjet numrin e përgjithshëm të noterëve për çdo rreth gjyqësor, si dhe mbulimin përkatës për çdo bashki, së bashku me njësitë administrative pranë saj.

Duke qenë se është plotësuar afati dyvjeçar i rishikimit të mëparshëm të numrit të përgjithshëm të noterëve, si dhe duke mbajtur në konsideratë zhvillimet në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” është i detyrueshëm rishikimi i numrit të përgjithshëm të noterëve, bazuar në kriteret ligjore të mëposhtme:

a) Numrin e popullsisë së bashkisë, së bashku

me njësitë administrative rreth saj;

b) Vëllimin e punës së veprimtarisë noteriale.

Në lidhje me kriterin e parë, Ministria e Drejtësisë është referuar në të dhënat zyrtare që publikon Instituti i Statistikave (INSTAT). Ndërkohë, në lidhje me kriterin e dytë, janë përdorur të dhënat për veprimtarinë noteriale të dërguara nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, si dhe nga Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH).

Procesi i caktimit të numrit të përgjithshëm të noterëve, si dhe shpërndarja e tyre në njësitë e qeverisjes vendore, duhet të udhëhiqet nga kriteret e vendosura nga ligji, si dhe nga parimet e efikasitetit dhe shpejtësisë së shërbimit, mbulimit me shërbim noterial të të gjitha njësive administrative të qeverisjes vendore, ngarkesës së noterëve, si dhe numrit të veprimeve noteriale për çdo banor. Përmbushja e kriterëve dhe e parimeve që duhet të udhëheqin këtë proces, kërkon analizimin me kujdes të numrit të noterëve për çdo njësi të qeverisjes vendore, numrit të popullsisë, numrit të veprimeve noteriale, si dhe nevojën për vende vakante gjatë dy viteve të ardhshme.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të neneve 3 dhe 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

Urdhëroj:

1. Numri i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, për dy vitet e ardhshme, të jetë 460 (katërqind e gjashtëdhjetë).

2. Numri i noterëve sipas njësive të qeverisjes vendore, për dy vitet e ardhshme, të jetë sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Shpalljen e vendeve vakante për njësitë e qeverisjes vendore, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Urdhri nr. 158, datë 9.4.2013 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre sipas njësive të qeverisjes vendore”, revokohet.

5. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani



ANEKSI NR. 1

NUMRI I NOTERËVE SIPAS NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

BASHKIA/NJËSI ADMINISTRATIVE NUMRI I NOTERËVE

Berat	8
Ura Vajgurore	1
Kuçovë	1
Çorovodë	1
Peshkopi	3
Burrel	2
Bulqizë	2
Durrës	46
Manëz	1
Sukth	2
Shijak	5
Rashbull	1
Krujë	2
Fushë-Krujë	2
Elbasan	25
Cërrik	1
Gramsh	2
Peqin	1
Librazhd	3
Fier	22
Patos	1
Levan	1



Lushnje	10
Divjakë	1
Ballsh	2
Gjirokastër	6
Dropull i Sipërm	1
Tepelenë	2
Përmet	2
Korçë	7
Maliq	1
Ersekë	1
Pogradec	6
Bilisht	2
Kukës	5
Bajram Curri	4
Lezhë	8
Rrëshen	2
Laç	6
Shkodër	20
Pukë	2
Koplik	1
Tiranë	182
Kamëz	5
Vorë	2
Farkë	3
Kashar	1



Paskuqan	1
Kavajë	8
Rrogozhinë	1
Vlorë	22
Himarë	1
Novoselë	1
Qendër-Vlorë	1
Sarandë	9
Delvinë	1

TOTAL 460

ANEKSI NR. 2

VENDET VAKANTE PËR ÇDO NJËSI TË QEVERISJES VENDORE

BASHKIA/NJËSI ADMINISTRATIVE NUMRI I VENDET VAKANTE

Bashkia Çorovodë	1
Bashkia Durrës	2
Bashkia Cërrik	1
Bashkia Elbasan	2
Bashkia Lezhë	1
Bashkia Fier	1
Bashkia Tiranë	11
Bashkia Kamëz	1
Bashkia Delvinë	1

TOTAL 21

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin numër 62-2016-363 (87), datë 26.1.2016, vendosi shpalljen të vdekur në datën 1.1.1965, të shtetasit Rahmi Çomo, i biri i Xhevdetit dhe i Asijes, i datëlindjes 27.5.1914, lindur në Libohovë.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë